



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KRYETAR

PROJEKT-VENDIM

Nr. 4, datë 19. 4.2024

PËR

“MIRATIMIN E TAVANEVE PËRFUNDIMTARE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2025-2027 PËR BASHKINË VAU DEJËS”.

Këshilli Bashkiak Vau Dejës në mbledhjen e tij të datës _____._____.2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9 pika 1.3, neni 34 dhe 41 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; neni 37 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NJQV”; VKB Vau Dejës nr 92 datë 21.12.2023 “Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe Buxhetit vjetor 2025”, Sipas Udhëzimit nr 3 datë 28.02.2024 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm vendor 2025-2027”, dhe sipas Udhëzimit Plotësues nr 8 datë 05.07.2024 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm vendor 2025-2027” dhe relacionit të administratës së Bashkisë Vau Dejës ,

V E N D O S I:

1. Të miratojë tavanet përfundimtare të programit buxhetor afatmesëm për vitet 2025 - 2027, të Bashkisë Vau Dejës, sipas relacionit shpjegues për procesin e përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm (sipas shtojcës 2, Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027) bashkëlidhur dokumentat e gjeneruar nga Sistemi i Menaxhimit të Buxhetit Vendor (SMBV), si më poshtë:
 - i. Raporti PBA 1: Tavanet e PBA sipas programeve
 - ii. Raporti PBA 2: Parashikimi i të ardhurave
 - iii. Raporti PBA 3: Shpenzimet e NJVQV dhe Programit dhe Klasifikimit Ekonomik
 - iv. Raporti PBA 4: Shpenzimet e NJVQV sipas Klasifikimit funksional (niveli I, II, III i COFOG)
 - v. Raporti PBA 5: Shpenzimet sipas Programit dhe Klasifikimit Ekonomik
 - vi. Raporti PBA 6: Deklarata e Politikës sipas Programeve
 - vii. Raporti PBA 7: Shpenzimet e Produkteve sipas Programeve
 - viii. Raporti PBA 8: Projektet e Investimeve
 - ix. Raporti PBA 9: Informacion mbi të dhënat e programit

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Kristian SHKRELI



Zv. Kryetar

Elvis Dregi

Zv. Kryetar

Ervis Molla

Zv. Kryetar

Aleksandra Gjoni

Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar

Elise Reme

Drejtoria Juridike e Integritit Prokurimeve dhe Aseteve

Drejtoria e Burimeve Njerëzore

Xhuma Kosi

Policia Bashkiake

Haris Osmani

Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Investimeve Publike

Ale Shumali

Drejtoria e Menaxhimit të Pyjeve, Inspektimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Devis Shkurtaj

Drejtoria e Shërbimeve Publike, Bujqësisë, Mbrojtjes Konsumatorit dhe Veterinarisë

Leorenc Petro

Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit

Devis Peci

Drejtoria e Mbrojtjes, Përfshirjes dhe Strehimit Social

Ridvan Luzaku

Bob Hani

Drejtoria e Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile

Bob Hani

TAVANET PËRFUNDIMTARE TË PROJEKT BUXHETIT AFATMESEM 2025-2027

Nr	Emertimi i Programit	2025				2026				2027			
		Paga dhe Sigurime shqetore & Shendetore	Shpenzime korente	Shpenzime kapitale	Totali i shpenzimeve Buxhetore	Paga dhe Sigurime shqetore & Shendetore	Shpenzime korente	Shpenzime kapitale	Totali i shpenzimeve Buxhetore	Paga dhe Sigurime shqetore & Shendetore	Shpenzime korente	Shpenzime kapitale	Totali i shpenzimeve Buxhetore
1110	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	159,674	28,075	800	188,549	186,671	30,491	12,000	229,162	192,636	30,491	12,000	235,127
1170	Gjendja civile	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
3140	Sherbimet e Policise Vendore	11,727	1,339	-	13,066	14,021	1,339	-	15,360	14,469	1,339	-	15,808
3280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	23,714	24,020	-	47,734	28,353	25,720	-	54,073	29,259	25,720	-	54,979
3280	Fondi i Mbrojtjes Civile	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
4130	Mbeshtetje per zhvillimin ekonomik	-	1,068	-	1,068	-	1,268	-	1,268	-	1,268	-	1,268
4220	Sherbimet Bujqesore, Inspektimi, Siguria Ushqimore&Mbrojtja e Kondumatoreve	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
4240	Menaxhimi i Infrastruktues se ujitjes dhe kullimit	10,861	17,689	730	29,280	12,986	20,542	6,000	39,528	13,401	20,787	6,000	40,188
4260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	10,073	598	-	10,671	12,043	299	7,000	19,342	12,428	299	7,000	19,727
4520	Rrjeti rrugor rural	5,947	2,612	166,700	175,259	7,110	2,381	49,200	58,691	7,338	2,381	56,222	65,941
4570	Transporti Publik	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
5100	Menaxhimi i mbetjeve	-	30,045	-	30,045	-	30,045	-	30,045	-	30,045	-	30,045
6140	Planifikimi Urban Vendore	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
6260	Sherbime publike vendore	29,687	9,178	500	39,365	35,494	12,718	8,000	56,212	36,628	15,328	8,000	59,956
6370	Furnizimi me uje dhe Kanalizime	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
7220	Sherbimet e kujdesit paresor	-	-	1,500	1,500	-	-	500	500	-	-	500	500
8130	Sport dhe Argetim	-	2,000	1,500	3,500	-	2,000	500	2,500	-	2,000	500	2,500
8220	Trashegimi Kulturore, Eventet Artistike dhe Kulturore	-	3,630	-	3,630	-	8,130	-	8,130	-	8,130	-	8,130
9120	Arsimi baze perfshire arsimin parashkollor	59,770	10,446	1,000	71,216	71,461	13,846	11,000	96,307	73,745	13,846	11,000	98,591
9230	Arsimi i mesem i pergjithshem	14,112	2,700	1,000	17,812	16,873	4,001	11,000	31,874	17,412	4,000	11,000	32,412
10430	Perkujdesi social	11,460	8,065	2,000	21,525	13,701	8,291	5,000	26,992	14,139	8,291	5,000	27,430
10661	Strehimi Sociale	-	500	1,000	1,500	-	500	6,719	7,219	-	500	6,719	7,219
4910	Fond rezerve	-	250	-	250	-	250	-	250	-	250	-	250
4940	Fondi i kontigjence	-	250	-	250	-	250	-	250	-	250	-	250
	TOTALI	337,025	142,465	176,730	656,220	398,713	162,071	116,919	677,703	411,455	164,925	123,941	700,321

Konceptoi:
Renado Doda



Miratoi:
Elsa Tanushi



KRYETAR

Kristian SHKRELI



3. Orientimi Afatgjatë i Bashkisë Vau Dejës

3.1 Strategjia e Zhvillimit Afatgjatë

Vizioni i zhvillimit të Vau-Dejës përbëhet nga objektivat strategjike vijuese:

- Pajisja me shërbimet bazë Lëvizja me mënyra të ndryshme
- Qendrat urbane
- Turizmi
- Bujqësia, blegtoria dhe kultivimi i peshkut
- Energjia

Objektivi i parë strategjik përfshin ato veprime të nevojshme për të pajisur territorin me kushtet minimale të strukturimit dhe funksionimit për të sjellë komunitetin lokal në gjendje për të ndërmarrë rrugën e zhvillimit. Bëhet fjalë për veprime që kryhen për të garantuar infrastrukturën bazë, shërbimt sociale thelbësore, sigurinë dhe gjallërinë. Ai artikullohet në programet e mëposhtme:

- Përmirësimi i rrjeteve teknike
- Ruajtja e peizazhit dhe siguria e territorit
- Shërbimet ndaj qytetarëve

Objektivi i dytë strategjik përmban veprime të nevojshme në përmirësimin e lëvizjes, dhe nëpërmjet formave të përshtatshme të integritetit të modaliteteve të ndryshme. Kjo artikullohet në programet me mëposhtme:

- Rrugët automobilistike
- Korridori lumor
- Ndërhyrje të tjera për lëvizjen

Objektivi i tretë strategjik synon të ndjekë objektivin për të realizuar në territor pole urbane, të afta për të ofruar funksionet komplekse të sistemit urban. Duke qenë përballë një situatë në të cilën zhvillimi i vendbanimeve ka ndjekur trende spontane dhe jo të udhëhequra, ky objektivi kërkon të krijojë një hierarki funksionale të qendrave të banuara, i konsideruar si kusht thelbësor që struktura urbane të kryejë një funksion aktiv në mbështetje të zhvillimit të komunitetit lokal. Programet që e përbëjnë atë janë:

- Pole shërbimi për territorin përreth
- Zhvillimi i qendrave lokale
- Rikualifikimi urban

Objektivi i katërt strategjik paraqet elemente të zhvillimit socio – ekonomik bazuar në mundësinë e përdorimit për qëllime turistike të burimeve të rinovueshme në territor. Bëhet fjalë për veprime që ndërmerren për t'i dhënë vlera potenciale natyrore dhe kulturore që ekzistojnë në territor. Programet në mbështetje të këtij objektiivi janë:

- Turizmi mjedisor
- Turizmi kulturor
- Ndërhyrjet e tjera për zhvillimin e turizmit

Objektivi i pestë strategjik ka tendencë të zhvillojë potencialin e lidhur me prodhimin primar të lidhur pikërisht me aktivitetin bujqësor, blegtoral dhe me kultivimin e peshkut. Programet e identifikuar janë:

- Strukturat e shërbimit
- Rritje e prodhimit

Objektivi i fundit strategjik kërkono të përqendrohet në zhvillimin e një resursi tjetër që është i pranishëm në mënyrë tradicionale në territor, atë të prodhimit të energjisë elektrike. Bëhet fjalë për veprime të ndërmarra për të zhvilluar prodhimin e energjisë nga burime të rinovueshme, edhe nëpërmjet diferencimit të cikleve të saj prodhuese. Programet e identifikuar janë:

- Zhvillimi i prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme
- Diferencimi i prodhimit të energjisë

Bashkimi sinergjik dhe plotësues i gjashtë objektivave strategjike të identifikuar, konsiderohet i përshtatshëm në përcaktimin e një vizioni të aftë për t'i dhënë komunitetit lokal një rrugë rrijteje dhe zhvillimi, duke u bazuar në efektin shumëfishues të veprimeve të veçanta.

3.2 Sfidat Kryesore të Zhvillimit / Paraqitja e Projekteve Kryesore – Arsyt dhe Përfituesit

- Menaxhimi i burimeve natyrore Shërbimet bujqësore dhe blegtorale
- Përmirësimi i aksesit në zonat rurale me qëllim zbutjen e pabarazive dhe ofrimin e shërbimeve administrative në të gjithë territorin e Bashkisë
- Menaxhimi i burimeve ujore Inkurajimi i efektivitetit dhe efikasitetit në kryerjen e shpenzimeve publike
- Lidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet prioritetëve strategjiko-politike të Qeverisjes Vendore me shpërndarjen e burimeve dhe kryerjen e shpenzimeve publike
- Zhvillimi ekonomik me theks në mjedis mjedisit në mënyrë që të garantohet mbrojtja e ekosistemeve dhe vlerave të shumta natyrore.
- Boshtet kryesore të zhvillimit ekonomik do të jenë zhvillimi rural (bujqësia dhe blegtoia), turizmi, industria e lehtë/përpunimi, shërbimet, dhe ekonomia e të ardhmes e bazuar në sistemet e teknologjisë së informacionit
- Integrimi i brezave të rinj në ekonomi, dhe krijimin e mundësive për iniciativat në kuadër të rritjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme

4. BUXHETI AFATMESËM I BASHKISË VAU DEJËS 2025-2027

Ky seksion i kushtohet alokimit të burimeve për shpenzime publike të Bashkisë Vau Dejës gjatë periudhës 2025-2027, si dhe projekteve kryesore të investimeve publike. Nënseksioni i parë, prezanton të ardhurat e parashikuara për periudhën 2025-2027, me një shpjegim për secilin grup të të ardhurave së bashku me supozimet kryesore të bëra gjatë parashikimit. Nënseksioni i dytë, paraqet një përmbledhje të planeve të shpenzimeve të Bashkisë për vitet 2025-2027. Ky nënseksion prezanton informacionin mbi shpenzimet totale sipas kategorive ekonomike, programit dhe funksioneve qeverisëse. Në vijim paraqiten projektet kryesore të investimeve publike të planifikuara nga Bashkia

Tabela 1 paraqet të dhëna bazë mbi bashkinë që përshkruajnë demografinë, sipërfaqen, komunitetin dhe bazën e biznesit, kapacitetin menaxhues, etj.

Tabela 1. Informacion Bazë mbi Bashkinë Vau Dejës

*[Vetëm pas plotësimit dhe miratimit të informacionit në Sistemin e Menaxhimit të Buxhetit Vjetor (SMBV), këtu duhet kopjuar **RAPORTI PBA9: INFORMACION MBI NJVQV/PROGRAMIN** e këtij sistemi. Në këtë rast ky raport duhet gjeneruar në nivel të NJVQV]*

4.1 Të Ardhurat dhe Shpenzimet Publike të Bashkisë Vau Dejës në vitet 2025-2027

4.1.1 Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë Vau Dejës për vitet 2025-2027

Ky nënseksion paraqet një përshkrim të secilit prej burimeve kryesore të të ardhurave, duke përfshirë të ardhurat e veta, taksat e ndara, transfertën e përgjithshme të pakushtëzuar dhe transfertat e pakushtëzuara sektoriale, transfertën e kushtëzuar, huamarrjet dhe të ardhurat e trashëguara. Informacioni jepet mbi: të ardhurat faktike të dy viteve të fundit; buxhetin fillestar dhe të pritshmin për vitin korent; dhe parashikimet për tre vitet e ardhshme.

Tabela 2. Të Ardhurat e Bashkisë sipas Burimit

[Vetëm pas plotësimit dhe miratimit të informacionit në SMBV, këtu duhet KOPJUAR RAPORTI PBA2: PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE i këtij sistemi.]

4.1.1.1 Të Ardhurat e Veta të Bashkisë Vau Dejës

Ky nënseksion paraqet informacion mbi të ardhurat e veta, përfshirë ato faktike për dy vitet e mëparshme, të pritshmet për vitin aktual dhe parashikimet për periudhën tre-vjeçare të PBA-së. Informacioni mbi supozimet që qëndrojnë në themel të këtyre parashikimeve paraqitet për secilin zë kryesor të të ardhurave të veta.

A. Taksat dhe Tarifat Vendore

A.1 Taksat Vendore

Taksat vendore përfshijnë taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin, si dhe mbi transaksionet e kryera me to; b) taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja; c) taksa vendore mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier; ç) taksa e tabelës; d) taksa vendore të përkohshme, të cilat vendosen sipas mënyrës së parashikuar në ligj; dh) taksa vendore mbi veprimtarinë ekonomike të biznesit të vogël; e) taksa vendore mbi të ardhurat vetjake, taksa mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimitë, testamentet ose lotaritë vendore; ë) taksa të tjera, të përcaktuara me ligj.

Parashikimi për vitet 2025-2027 ka një rritje të lehtë, nga viti në vit, ku bazohet te zgjerimi i bazës së taksapaguesve nëpërmjet:

- *Percaktimit të sakte të kryefamiljareve sipas rregjistrimit të gjendjes civile.*
- *Mbështetja nga agjentë tatimorë,*
- *Rritja pak a shumë e nr. bizneseve aktive, duke formalizuar aktivitetet e tyre.*
- *Rritja e nr. të sipërfaqeve të ndërtesave nga ndërtimet e reja, si dhe evidentim i matjeve të sipërfaqeve të objekteve të bizneseve.*
- *Rritja e nr. të formalizimit të pronave, nëpërmjet certifikatave të pronësive dhe lejeve të legalizimit.*
- *Shtrirje e mëtejshme e bazës taksapaguese, falë politikave fiskale lehtësuese dhe incentivave të ndërmarra, rivlerësimit të gjendjes faktike, përmirësimit të shërbimit dhe marrëdhënies me taksapaguesin, bashkëpunimit të pritshëm me institucione si ZRRPP, ALUIZNI,*
 - *Krijimi dhe implementimi i programit të taksave vendore, i cili ka ndikuar në përmirësimin e cilesive saktësisë së të dhënave si dhe në zgjerimin e bazës së taksapaguesve, dhe shpejtesisë për kryejën e shërbimit, gjithashtu ndikon në uljen e evazionit fiskal.*

A.2 Tarifat Vendore

Tarifat vendore përfshijnë tarifat për:

a) tarifa për zënien dhe përdorimin e hapësirës publike dhe të fasadave; b) tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve; c) tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizimet; ç) tarifa për shërbimin e ujitjes dhe të kullimit; d) tarifa për shërbimet administrative dhe dhënien e licencave, lejeve e autorizimeve; dh) tarifa të përkohshme, në përputhje me rrethana të përcaktuara në ligj; e) tarifa të tjera, të përcaktuara nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore; ë) tarifa të tjera, të përcaktuara në ligj.

Parashikimet në rritje të tarifave për periudhën 2025-2027, ka ardhur si rezultat i faktoreve të mëposhtem:

- *Rritja e tarifës së pastrimit dhe ndricimit duke filluar në vitin 2024, nga rritja e kostonë së ketyre shërbimeve.*
- *Ndryshimet e sipërfaqeve të ndertesave të objekteve të bizneseve, ku biznesi i vogël tarifën e pastrimit e ka në varesi të sipërfaqes së ndertesës, e cila ka pësuar rritje*
- *Formalizimi i shumë bizneseve dhe dhënia e licencave, autorizimeve të automjeteve.*
- *Rritja e shpenzimeve nga Bashkia për shërbimin e ujitjes kullimit, duke pastruar të gjithë kanalet kulluese dhe vaditeve.*
- *etj*

B. Të ardhurat nga Menaxhimi i Pasurive Publike

Të ardhurat nga menaxhimi i pasurive publike përfshijnë të ardhurat e gjeneruara nga dhënia me qira e tokës bujqësore, pronës, tokës dhe pajisjeve palëve të treta.

Të ardhurat e parashikua me rritje kanë ardhur si rezultat i rritjes së dhënies me qira të pronave publike të Bashkisë së Sidomos në pyje dhe kullota, ku është rritur numri i kërkesave për marrje me qira, këtu ka ndikuar edhe hapësirat reklamuese për zhvillimin e turizmit në territorin e Bashkisë Vau dejes.

C. Të Ardhura të Tjera të Veta

Të ardhurat e tjera përfshijnë ato të gjeneruara nga: pozicionet aksionare të bashkisë; ndëshkimet dhe gjobat; grante nga marrëveshjet ndërkombëtare apo nga qeveritë e huaja; etj.

Ndryshimet kanë ardhur si rezultat i fakteve të viteve të kaluara ku ka pasur grante të brendshme dhe nga OJF, gjithashtu edhe në të ardhmen pritet të ketë marrëveshje dhe bashkëpunime me shoqata të ndryshme.

4.1.1.2 Të ardhurat nga Taksat e Ndara

Bashkia merr një pjesë të të ardhurave të mbledhura nga qeveria qendrore nga tatimi mbi të ardhurat personale, taksa e regjistrimit të automjeteve dhe renta minerale. Informacioni për këto të ardhura është paraqitur në këtë nën-seksion.

A. Tatimi mbi të Ardhurat Personale

Të ardhurat e ndara nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale përfshijnë tatimin mbi të ardhurat personale si të nëpunësve publikë, ashtu edhe të atyre të punësuar në sektorin jo-publik si dhe tatimin mbi të ardhurat e krijuara nga individë nga interesi, qiraja, llotaritë, lojërat dhe burime të tjera.

Te ardhurat nga Tatimi mbi të ardhurat personale kanë qenë në rritje vitet e kaluara, dhe orientimet janë të kënaqësive edhe për vitet e ardhshme, prandaj edhe parashikimi ka trend rritës.

B. Taksa për qarkullimin e mjeteve të përdorura

Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura është pjesë e taksave të ndara. Njësitë e vetëqeverisjes vendore përftojnë 25% të të ardhurave totale të gjeneruara nga kjo taksë.

Taksa e mjeteve të përdorura është një taksë që na ndikon në të ardhurat totale, e cila ka pësuar rritje nga viti në vit, prandaj edhe kjo taksë është parashikuar me rritje.

C. Renta Minerare

Çdo person fizik ose juridik, i cili është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për këtë fushë, duhet të paguajë qira për burimet natyrore të nxjerra nga, mbi/nën tokën e Republikës së Shqipërisë. Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore ku kryhet aktiviteti marrin 5 përqind të të ardhurave nga renta minerare.

Te ardhura nga renta minerare është një e ardhur e paperfillshme, ku edhe parashikimi është sa për formë, sepse nuk pritet ndonjë e ardhur ndikuese.

D. Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme (97 përqind e të ardhurave nga taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme për individë, personat fizikë dhe juridikë).

Kjo e ardhur nuk ka pësuar rritje, pasi është me luhatje një vit mund të kemi, ndërsa vitin tjetër jo, kjo varet nga procedurat dhe kërkesat e subjekteve për një veprim të tillë nga ASHK.

4.1.1.3 Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme

Të ardhurat nga transfertat e pakushtëzuar e përgjithshme për periudhën afatmesme që i kalojnë pushtetit vendor komunikohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë përmes Udhëzimit Vjetor dhe atij Plotësues të Përgatitjes së PBA-së.

4.1.1.4 Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale

Të ardhurat nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale për periudhën afatmesme komunikohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë përmes Udhëzimit Vjetor dhe atij Plotësues të Përgatitjes së PBA-së.

2.1.2 Plani i Shpenzimeve të Bashkisë Vau Dejës për periudhën 2025-2027

Tabela 3, paraqet shpenzimet faktike, të buxhetuara dhe të planifikuara të Bashkisë mbi baza vjetore për secilën kategori ekonomike të shpenzimeve gjatë periudhës 2022 deri në 2027.

Tabela 3. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas kategorive ekonomike.

[Vetëm pas plotësimit dhe miratimit të informacionit në SMBV, këtu duhet KOPJUAR RAPORTI PBA3: SHPENZIMET E NJVQV DHE PROGRAMIT SIPAS KLASIFIKIMIT EKONOMIK i këtij sistemi. Në këtë rast, ky raport duhet gjeneruar në nivel NJVQV]

Tabela 4, paraqet shpenzimet totale faktike, të buxhetuara dhe të planifikuara të Bashkisë mbi baza vjetore për secilin program buxhetor për periudhën 2022-2027.

5. BUXHETI AFATMESËM PËR PROGRAMET BUXHETORE

Buxheti total i Bashkisë Vau Dejës menaxhohet sipas 22 programeve të shpenzimeve. Ky seksion i dokumentit të PBA-së paraqet planet e shpenzimeve që lidhen me performancën për secilin vit të PBA-së, për secilin nga programet e shpenzimeve të Bashkisë. Çdo nën-seksion (3.1 deri në 3.X) paraqet informacionin e performancës të planifikuar dhe kostot përkatëse për një program. Për secilin program informacioni i paraqitur konsiston në:

- Shpenzimet totale të programit sipas kategorisë ekonomike (paga dhe sigurime, shpenzime korente dhe shpenzime kapitale) për dy vitet e kaluara (fakti), vitin aktual (buxheti fillestar dhe i pritshmi) dhe tre vitet e ardhshme (parashikimi);
- Politika e Programit (qëllimet e politikës së programit, objektivat e programit dhe treguesit përkatës të performancës);
- Planet e shpenzimeve të Produkteve të Programit;
- Projektet e investimeve; dhe
- Të dhëna dhe statistika të përgjithshme të programit.

Tabela 5, paraqet informacion mbi shpenzimet totale të programit sipas kategorive ekonomike për dy vitet e mëparshme (faktin), vitin aktual buxhetor (buxheti fillestar dhe i pritshmi) dhe tre vitet e ardhshme të PBA-së (parashikimi).

Tabela 5. Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike

[Vetëm pas plotësimit dhe miratimit të informacionit në SMBV, këtu duhet KOPJUAR RAPORTI PBA3: SHPENZIMET E NJVQV DHE PROGRAMIT SIPAS KLASIFIKIMIT EKONOMIK i këtij sistemi. Në këtë rast, ky raport duhet gjeneruar në nivel programi]

5.1.1 Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit

Ky nënseksion ofron informacion mbi planet e performancës së programit. Deklarata e Politikës së Programit është paraqitur në Tabelën 6, duke artikuluar qëllimet e politikës së programit, objektivat e politikës së programit dhe treguesit përkatës të performancës për çdo vit të PBA-së.

Tabela 6. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit

[Vetëm pas plotësimit dhe miratimit të informacionit në SMBV, këtu duhet KOPJUAR RAPORTI PBA6: DEKLARATA SË POLITIKËS SË PROGRAMIT i këtij sistemi.]

5.1.2 Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit

Ky nënseksion, ofron informacion mbi planet e ofrimit të shërbimeve të programeve dhe kostot përkatëse. Për secilin Objektiv të Politikës së Programit, paraqitet informacion për produktet që do të kontribuojnë në arritjen e këtyre objektivave. Informacioni për produktet përfshin emrin e produktit, përshkrimin e produktit, sasinë e planifikuar, shpenzimet totale dhe shpenzimet për njësi të produktit.

Tabela 7. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit

[Vetëm pas plotësimit dhe miratimit të informacionit në SMBV, këtu duhet KOPJUAR RAPORTI PBA7: SHPENZIMET E PRODUKTEVE TË PROGRAMIT i këtij sistemi.]

5.1.3 Projektet e Investimeve të Programit

Tabela 8. Projektet e Investimeve të Programit

[Vetëm pas plotësimit dhe miratimit të informacionit në SMBV, këtu duhet KOPJUAR RAPORTI PBA8: PROJEKTET E INVESTIMEVE i këtij sistemi.]

5.1.4 Informacione Bazë mbi Programin

Ky seksion i dokumentit paraqet të dhëna dhe statistika specifike të programit, që mund ta ndihmojnë lexuesin të kuptojë më mirë profilin dhe kontekstin e programit.

Tabela 9. Informacione bazë mbi Programit

[Vetëm pas plotësimit dhe miratimit të informacionit në SMBV, këtu duhet KOPJUAR RAPORTI PBA9: INFORMACION MBI NJVQV/PROGRAMIN i këtij sistemi. Në këtë rast ky raport duhet gjeneruar në nivel programi]

6. BUXHETI VJETOR

Dokumentacioni i Buxhetit Vjetor konsiston në raportet e mëposhtme të gjeneruara nga Sistemi i Menaxhimit të Buxhetit Vendor.

6.1. Dokumentacioni Bazë

- Raporti BV1: Buxheti i NJVQV sipas Programeve dhe Njësive Shpenzuese
- Raporti BV2: Tavanet e PBA sipas Programeve
- Raporti BV3: Parashikimi i të Ardhurave
- Raporti BV4: Shpenzimet e NJVQV sipas Klasifikimit Ekonomik
- Raporti BV5: Numri i Punonjësve të NJVQV

6.2. Dokumentacioni Shoqërues

- Raporti BV6: Shpenzimet e NJVQV sipas Klasifikimeve Buxhetore
- Raporti BV7: Lista e Projekteve të Investimeve të NJVQV
- Raporti BV8: Efekti Financiar I Përrjashtimeve apo Lehtësimeve Fiskale
- Raporti BV9: Lista e Njësive Shpenzuese të NJVQV
- Raporti BV10: Deklarata e Politikës së Programit
- Raporti BV11: Detyrimet e Prapambetura
- Raporti BV12: Plani i Menaxhimit të Risqeve
- Raporti BV13: Lista e Projekteve Konkensionare / PPP
- Raporti BV14: Shoqëritë Aksionere Publike
- Raporti BV15: Plani i Arkës